VENDIM
Nr. 421, datë 26.6.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 175, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, "Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar", që përmendet në pikën 2, të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në rreshtat me numrat rendorë 13 dhe 14, fjalët "... ciklin e ulët ..." zëvendësohen me "... arsimin fillor ...".

2. Rreshti me numrin rendor 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

15	Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare Instruktor i praktikës profesionale	3	2% e PG	5% e PG 10% e PG 15% e PG	34.000

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe